

BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI PËR NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME

RAPORTI GJASHTËMUJOR “MBI ECURINË
E KËRKESËS MINIMALE PËR INSTRUMENTE
TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE
DETYRIME TË PRANUARA – MREL”

GJASHTËMUJORI I DYTË I VITIT 2025

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408


E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org



P Ë R M B A J T J A

<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL</i>	<i>8</i>
<i>II. STRUKTURA E FINANCIMIT TË MREL</i>	<i>11</i>
<i>III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL</i>	<i>17</i>
<i>IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR</i>	<i>21</i>
<i>ZHVILLIMET NË PËRFITUESHMËRI</i>	<i>21</i>
<i>ZHVILLIMET NË KOSTON E FINANCIMIT</i>	<i>23</i>





PËRMBLEDHJE

Ky raport përmbledh zhvillimet kryesore të sektorit bankar në terma të përmbushjes së “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”- MREL. Raporti i parë u hartua në fillim të vitit 2024 dhe analizonte zhvillimet kryesore që prej vitit 2021, pas hyrjes në fuqi të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, me fokus të veçantë fundin e vitit 2023. Ky raport, i cili përfaqëson raportin e pestë në radhë, përqendrohet në zhvillimet e ndodhura gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025 lidhur me ecurinë dhe përmbushjen e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”- MREL. Raporti do të vijojë të përditësohet në terma gjashtëmujorë.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025, 5 banka të sektorit bankar i nënshtrohen kuadrit rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përmbushur kërkesën për MREL. Për këtë gjashtëmujor, këto banka kanë ruajtur një kontribut të qëndrueshëm në zhvillimet e sektorit bankar, duke zënë një peshë prej rreth 73% të aktiveve të sektorit dhe 72% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR). “Rikapitalizimi nga brenda” është strategjia e preferuar e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për këto banka, e cila mbështetet në përmbushjen e plotë të kërkesës për MREL, brenda vitit 2027.

Sektorit bankar përmbushi plotësisht kërkesën e ndërmjetme për MREL. Objektivi i ndërmjetëm i kërkesës për MREL për vitin 2025, është mesatarisht në 20.2% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kundrejt objektivit të ndërmjetëm të vitit 2024 prej 18.2%. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar e ka përmbushur plotësisht objektivin e ndërmjetëm, duke arritur një kapacitet mesatar të MREL-it në nivelin 25.1% të EPR.

Bankat kanë qenë aktive në financimin e plotë të kërkesës përfundimtare për MREL. Objektivi përfundimtar që duhet të përmbushet brenda vitit 2027, mesatarisht qëndron në nivelin 24.9% të EPR njësoj me një vit më parë. Emetimi i titujve financiarë të pranuar për MREL gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025, ka tkurrur hendekun negativ të sektorit për përmbushjen e objektivit përfundimtar të MREL. Në fund të vitit 2025, mesatarisht, kapaciteti i kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar për bankat MREL paraqitet me tepriçë pozitive 0.2 pikë përqindje ndaj nivelit përfundimtar të MREL, në ndryshim nga viti 2024, ku hendeku negativ shënonte një nivel prej 2 pikë përqindje.

Kapitali rregullator përbën burimin kryesor të financimit të MREL, ndërsa titujt financiarë të pranuar për MREL përbëjnë përsëri peshën kryesore të detyrimeve të pranuar. Në dhjetor 2025, kapitali bazë i nivelit të parë ka financuar nivelin e MREL me 19.5% të EPR; kapitali i nivelit të dytë ka financuar 1.9% të EPR; borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator ka një kontribut të



qëndrueshëm në 0.3% të EPR; ndërsa instrumentet financiare të pranuar për MREL kanë rritur financimin në rreth 3.4% të EPR.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2025 shënon nivel aktiv të aktivitetit të bankave për emetimin e titujve financiarë për qëllime të kërkesave rregullatore, kundrejt gjashtëmujorit të dytë 2024. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar emetoi, në formën e obligacioneve me ofertë private, 7.1 miliardë lekë. Totali i emetimeve për të gjithë vitin 2025 shënon rreth 12.5 miliardë lekë, kundrejt emetimeve prej 9.2 miliardë lekë një vit më parë.

Kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur këto emetime mbetet i kënaqshëm. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, investitorët në treg kanë blerë rreth 63% të vlerës totale të titujve të miratuar për emetim, ndërkohë që për gjithë vitin ky raport shënon 73% të totalit të emetimeve të miratuara. Individët përbëjnë bazën kryesore të investitorëve¹, me rreth 99% të totalit.

Normat e interesit në tregun e kapitalit për emetimet në monedhën Lek kanë pasur prirje rënëse, duke e mbyllur vitin 2025 në të njëjtin nivel me vitin 2024, ndërsa normat e interesit për emetimet në monedha të huaja kanë shënuar rritje. Zhvillimet në normat e interesit reflektojnë zhvillimet në tregun financiar, ofertën e titujve dhe natyrën e borxhit të varur dhe atij të paguarantuar. Në fund të vitit 2025, norma mesatare e interesit për emetimin në monedhën Lek vijon të mbetet në të njëjtin nivel prej 4.5% krahasuar me vitin 2024, ndërsa norma në monedhën Euro ka shënuar një rritje prej rreth 0.4 pikë përqindjeje. Një ndryshim më të ndjeshëm ka pësuar norma e interesit për monedhën Dollar amerikan, duke reflektuar një rritje në 5% nga 3.5% në fund të vitit 2024.

Maturiteti i letrave me vlerë të emetuara në tregun e kapitalit në Shqipëri reflekton afate të qëndrueshme maturimi. Përgjatë vitit 2025, emetimi i titujve të borxhit të paguarantuar është bërë për afate maturimi nga 3 deri në 5 vite, ndërsa instrumentet e borxhit të varur janë emetuar me afate maturimi 7-vjeçare, të realizuara në monedhën kombëtare dhe në monedha të huaja.


Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL paraqesin zhvillime të qëndrueshme në përfitueshmëri, në linjë me zhvillimet e sektorit. Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2025, rezultati neto nga interesi për këto banka pësoi një rritje vjetore prej 1.5%, duke shënuar një nivel prej 72.6 miliardë lekësh. Marzhi neto nga interesi shënoi një rënie të lehtë, në nivelin 3.9% kundrejt nivelit prej 4.3% që shënonte në fund të vitit 2024.

¹ Sipas nenit 11 të rregullores nr. 78/2020, për qëllime të përmbushjes së "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar", njohja e instrumenteve të detyrimeve të pranuar që zotërohen nga klientët joprofesionistë, bëhet pasi banka kryen testin e përshtatshmërisë, sipas dispozitave të ligjit "Për tregjet e kapitalit" dhe përcakton se në bazë të testit të kryer "...instrumenti është i përshtatshëm për klientin joprofesionist". Dokumentimi i kryerjes së testit të përshtatshmërisë bëhet sipas dispozitave të ligjit "Për tregjet e kapitalit".



Në vijim të zhvillimeve në treguesit e përfitueshmërisë, kostoja e financimit të kërkesës për MREL vlerësohet e përballeshme. Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2025, shpenzimet për interesa për borxhin e varur dhe letrat me vlerë përbëjnë 3.5% të rezultatit neto nga interesi, për bankat të cilat u nënshtrohen kërkesës për MREL, nga 3.4% në fund të vitit 2024. Banka të veçanta, të cilat kanë një histori më të gjatë të emetimit të titujve të borxhit për qëllime rregullatore, kanë një peshë më të lartë të këtij treguesi, i cili gjithsesi mbetet i kufizuar në ndikimin që ka në përfitueshmëri.

Simulimet në lidhje me ndjeshmërinë e kostos së financimit të MREL ndaj rritjes së normës së interesit në treg, tregojnë për aftësi të mira të përthithjes së kostos shtesë për sektorin bankar. Gjithsesi, banka të veçanta, të cilat kanë një varësi më të lartë nga financimi i titujve të borxhit në treg për shkak të nivelit më të ulët të kapitalit rregullator, shfaqin një ndjeshmëri më të lartë.




I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL

Në zbatim të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe në përputhje me strategjinë e preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka komunikuar kërkesën për MREL për secilën bankë që prej vitit 2021. Në kuadër të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë periodike përmbushjen e kërkesës për MREL.


Për vitin 2025, në zbatim të strategjisë së “rikapitalizimit nga brenda” të identifikuar nga Banka e Shqipërisë, 5 nga 11 bankat e sektorit duhet të përmbushin kërkesën për MREL. Kjo strategji nënkupton që këto banka duhet të mbajnë në bilancin e tyre burime të mjaftueshme financiare, të cilat mund të zhvlerësohen dhe të konvertohen në kapital, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë raport, grupi i bankave që duhet të përmbushin kërkesën për MREL identifikohet si “bankat MREL”. Për bankat e tjera, strategjia e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë mbetet likuidimi i detyruar, në kushtet kur kjo strategji vlerësohet aktualisht se nuk cenon stabilitetin financiar në vend.

Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025, pesha e bankave MREL sipas aktiveve totale dhe nivelit përkatës të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR), ka shfaqur një tendencë të lehtë rëniejeje, duke qëndruar pranë nivelit mesatar të vitit të fundit (dhjetor 2024-dhjetor 2025). Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, këto banka përbëjnë mesatarisht 73% të totalit të aktiveve dhe 72% të EPR të sektorit bankar. Kjo ecuri reflekton një kontribut relativisht të qëndrueshëm të aktivitetit të grupit të bankave MREL në zhvillimet e sektorit bankar gjatë periudhës së zbatimit të kërkesave rregullore me fokus ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Grafik 1. Pesha në sektor për bankat me strategji ndërhyrjen e jashtëzakonshme, 2021- 2025




Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.




Në zbatim të rregullores nr. 78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar", Banka e Shqipërisë komunikon çdo vit nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL që bankat duhet të plotësojnë brenda 12 muajve të ardhshëm, si dhe nivelin përfundimtar që duhet të plotësohet brenda vitit 2027. Për vitin 2025, objektivi i ndërmjetëm i kërkesës për MREL, në terma mesatarë, qëndroi në 20.2% të EPR dhe ai përfundimtar në 24.9% të EPR. Niveli i ndërmjetëm i kërkesës MREL për vitin 2025, u rrit në terma mesatarë me 2 pikë përqindje të EPR, duke reflektuar rritjen vjetore drejt përbushjes së objektivit përfundimtar të MREL në vitin 2027.

Spektori bankar e ka përbushur plotësisht objektivin e ndërmjetëm të MREL për vitin 2025. Në fund të kësaj periudhe, kapaciteti i bankave për kërkesën për MREL në nivel individual është luhatur në intervalin 24.1% - 26.3% të EPR, duke qëndruar mbi nivelin mesatar të kërkesës minimale të ndërmjetme, të komunikuar nga Banka e Shqipërisë.



Gjatë vitit 2025, sektori bankar ka përbushur plotësisht objektivin e ndërmjetëm për MREL për secilin tremujor, me një tepricë që luhetet nga 2.1% deri në 4.9% të EPR. Në lidhje me objektivin përfundimtar, sektori bankar e ka zvogëluar gradualisht hendekun që duhet të plotësojë deri në vitin 2027, nëpërmjet emetimeve të reja të instrumenteve financiare me fokus financimin e MREL. Për rrjedhojë, gjatë vitit 2025, hendeku negativ i tre tremujorëve të parë është plotësuar, dhe në tremujorin e katërt, bankat MREL paraqesin një tepricë pozitive prej 0.2 pikë përqindje, lidhur me objektivin që duhet të përbushin brenda vitit 2027. Që nga komunikimi për herë të parë i kësaj kërkesë rregullatore, në fund të vitit 2025, kapaciteti mesatar i kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar për bankat MREL paraqitet me tepricë pozitive ndaj nivelit përfundimtar të MREL në terma mesatarë, në ndryshim nga viti 2024, ku hendeku negativ shënonte një nivel prej 2% të EPR.





Në nivel individual, bankat të cilat kanë një pozicion të kapitalit rregullator poshtë ose pranë nivelit mesatar të sektorit, paraqesin një hendek më të lartë të nevojës për financim të MREL-it. Ky nivel, në fund të vitit 2025, luhet në intervalin 0.5% - 1.9% të EPR, duke shënuar një tkurrje të tij me rreth 3 pikë përqindje, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2024. Me gjithë përmirësimin e dukshëm të treguesit, bankat MREL do të duhet të vijojnë me financimin e kërkesës për MREL, në përputhje me objektivat vjetorë dhe përfundimtarë që komunikohen nga Banka e Shqipërisë.




II. STRUKTURA E FINANÇIMIT TË MREL


Pas hyrjes në fuqi të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe monitorimit periodik të zhvillimeve të tregut për përmbushjen e kësaj kërkesë, gjatë pjesës së dytë të vitit 2025, bankat MREL kanë vijuar të emetojnë instrumente financiare në trajtën e detyrimeve të pagarantuara. Në ndryshim nga periudha 2022-2023, ku sektori bankar është mbështetur kryesisht në zërat e kapitalit rregullator dhe borxhin e varur për përmbushjen e kërkesës për MREL, në fund të vitit 2023, u emetuan për herë të parë titujt financiarë me përparësi të lartë (senior), për qëllime të përmbushjes së kërkesave rregullatore. Kjo tendencë vijoi edhe përgjatë vitit 2024 dhe vitit 2025, ku u realizuan ndjeshëm emetime të titujve financiarë në trajtën e obligacioneve të pagarantuara, si dhe huave nga institucione ndërkombëtare apo banka mëmë për grupe bankare, të emetuara si detyrime të pranuar.

Më konkretisht, stoku i kapitalit bazë të nivelit të parë për bankat MREL vijoi prirjen rritëse në terma vjetorë, duke arritur në dhjetor 2025 në nivelin 159.5 miliardë lekë kundrejt 145.6 miliardë lekëve që shënonte në fund të vitit 2024. Ky përmirësim reflekton ndikimin pozitiv të përfitueshmërisë së sektorit bankar në forcimin e vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit bazë. Gjatë vitit, evidentohet gjithashtu një trend rritës edhe për kapitalin e nivelit të dytë, i cili shënon vlerën 15.9 miliardë lekë, nga 11.3 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Grafik 4. Struktura e financimit të MREL në miliardë lekë, T4 2022-2025



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.



Detyrimet e pranuara² kanë shënuar rritje gjatë pjesës së dytë të vitit 2025. Në nivel stoku, detyrimet e pranuara shënuan një rritje prej rreth 7.9 miliardë lekësh kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit, duke arritur në nivelin 29.7 miliardë lekë në fund të vitit 2025. Ky stok përbëhet nga rreth 2.1 miliardë lekë borxh i varur i paklasifikuar si kapital rregullator, 20.8 miliardë lekë detyrime senior jopreferenciale dhe rreth 6.8 miliardë lekë detyrime senior (me përparësi të lartë) të pakolateralizuara. Detyrimet senior jopreferenciale shënuan një rritje prej rreth 5.8 miliardë lekësh kundrejt gjashtëmujorit të parë, duke reflektuar emetimin e obligacioneve të pagarantuara të bankave MREL gjatë gjashtëmujorit të dytë 2025.

Në fund të vitit 2025, struktura e financimit të kapacitetit të MREL (Grafik 5) ka shënuar ndryshime në krahasim me fundin e vitit 2024. Pas uljes së financimit nga kapitali rregullator me rreth 5 pikë përqindje (ulje e financimit nga kapitali bazë i nivelit të parë me 6 pikë përqindje dhe rritje prej 1 pikë përqindjeje nga financimi me kapital të nivelit të dytë), financimi nëpërmjet detyrimeve të pagarantuara (me përparësi të lartë dhe jopreferenciale) është rritur ndjeshëm në 13%, nga 8% në fund të vitit 2024.

Në terma të kontributit në kapacitetin e MREL (Grafik 5), kapitali bazë i nivelit të parë përbën kontribuuesin kryesor, duke financuar mesatarisht rreth 78% të totalit. Gjithsesi, nga tremujori i fundit i vitit 2024 deri në tremujorin e fundit të 2025, struktura e financimit të kapacitetit të MREL ka pësuar disa ndryshime, ku pas kontributit të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, detyrimet e pranuara kanë një kontribut në rritje në financimin e MREL, duke reflektuar intensifikimin e aktivitetit të sektorit bankar në emetimin e titujve në tregun e brendshëm. Në fund të vitit 2025, kapitali i nivelit të dytë ka financuar mesatarisht rreth 8% të nivelit të MREL, me një rritje të lehtë prej 1 pikë përqindjeje kundrejt fundit të vitit 2024. Kontributi që vjen nga borxhi i varur i paklasifikuar si kapital rregullator paraqitet i qëndrueshëm në rreth 1% të stokut të MREL, duke ruajtur të njëjtin nivel financimi si në fund të vitit 2024.


Së fundi, detyrimet senior me përparësi të lartë dhe ato jopreferenciale kanë financuar rreth 13% të totalit të MREL, nga 8% që evidentohet në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke reflektuar aktivitetin në rritje të sektorit bankar që prej gjysmës së dytë të vitit 2023, në drejtim të financimit të MREL me këto instrumente. Financimi i strukturës së MREL me detyrime të pranuara shënoi një rritje prej 2 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2025

² Detyrimet e pranuara përbëhen nga (i) instrumentet që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 9, të rregullores nr. 78/2020 "Kushtet për njohjen e instrumenteve për përmbushjen e "kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuara", në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të kapitalit të nivelit të dytë; dhe (ii) instrumente të kapitalit të nivelit të dytë me maturimin e mbetur më të gjatë se një vit, në atë masë që nuk klasifikohen si zëra/elemente të kapitalit të nivelit të dytë, në përputhje me rregulloren "Për kapitalin rregullator". Dispozitat kontraktuale të instrumenteve të emetuara nga sektori bankar si "detyrime të pranuara" parashikojnë se, në rast të likuidimit të detyruar, pretendimi mbi instrumentin renditet në klasën kreditore "d" të nenit 121 "Radha e shlyerjes së detyrimeve" të ligjit nr. 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Në terma të detyrimeve të bankës të tilla si ato të nënrenditura dhe të instrumenteve të kapitalit, këto instrumente renditen me përparësi (senior), duke i përthithur humbjet pas aksionerëve apo pretendimeve që rezultojnë nga zërat e kapitalit dhe detyrimeve të nënrenditura.



dhe 5 pikë përqindjeje kundrejt fundit të vitit 2024, duke paraqitur një strukturë të ngjashme dhe të qëndrueshme përgjatë vitit 2025.


Grafik 5. Struktura e financimit të MREL në përqindje, T4 2022 - 2025



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Në terma të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kapitali bazë i nivelit të parë përbën mesatarisht 19.5% të EPR në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025, kundrejt nivelit 19.2% të EPR në fund të vitit 2024 (Grafik 6). Kapitali i nivelit të dytë ka një rritje të financimit në nivelin 1.9% të EPR kundrejt 1.5% të EPR në fund të vitit 2024, ndërsa borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator ruan qëndrueshmëri financimi në 0.3% të EPR. Emetimet e titujve të njohur si detyrime të pagarantuara kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për financimin e MREL. Në dhjetor 2025, ato arrijnë në total në rreth 3.4% të EPR, nga 2.5% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit dhe 1.9% në fund të vitit 2024, duke evidentuar rritjen e vazhdueshme të aktivitetit të sektorit bankar në emetimin e këtyre instrumenteve.


Grafik 6. Struktura e financimit të MREL në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, T4 2022 - 2025



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.




Zhvillimet në ecurinë e kërkesës për MREL gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2025 (Grafik 7), pasqyrojnë rritjen e mëtejshme të financimit të sektorit bankar nëpërmjet detyrimeve të pranura dhe uljen e varësisë së financimit nëpërmjet kapitalit rregullator.



Kontributi i këtyre zhvillimeve në kapacitetin e MREL gjatë pjesës së dytë të vitit 2025 është paraqitur në Grafikon 8. Në fund të vitit 2025, kapaciteti i MREL paraqitet në 25.1% të EPR nga 22.6% të EPR që shënonte në fund të gjashtëmuajorit të parë 2025, duke u rritur me rreth 2.5 pikë përqindje. Ky ndryshim vjen si rezultat i rritjes së kapitalit rregullator, ku kontributi i kapitalit bazë të nivelit të parë është rreth 1.6 pikë përqindje. Ndryshimi i stokut të borxhit të varur me maturitet të mbetur mbi 1 vit, i cili nuk klasifikohet si kapital rregullator, ka sjellë një kontribut prej rreth 0.6 pikë përqindjeje në nivelin e MREL për periudhën. Ndërkohë, stoku i detyrimeve të pagarantuara ka kontribuar për një rritje prej 1 pikë përqindjeje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025. Ky efekt pozitiv është ndikuar në të kundërt (negativisht) nga zgjerimi i ekspozimeve të ponderuara me rrezik, të cilat kanë ndikuar në rënien e kapacitetit MREL me 0.7 pikë përqindje.



Grafik 8. Kontributi në financimin e MREL përgjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2025



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar në Shqipëri ka vijuar zgjerimin e aktivitetit bankar gjatë periudhës. Për gjashtëmuajorin e dytë 2025, ekspozimet e ponderuara me rrezik të sektorit bankar në tërësi kanë shënuar një rritje prej 9.0% në terma vjetorë dhe prej 3.4% në terma gjashtëmuajorë. Për bankat MREL, kjo rritje është përkatësisht 8% dhe 3.2%.

HAPËSIRË INFORMUESE: BURIMET E FINANCIMIT TË INSTRUMENTEVE PËR MREL NË TREGUN NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2025, sektori bankar ka vijuar të diversifikojë strategjinë e financimit të kërkesës MREL, duke rritur financimin përmes burimeve në tregun ndërkombëtar.

Këto zhvillime pozitive u shënuan që prej vitit 2023, vit në të cilin sektori bankar u financua me sukses për herë të parë nga institucionet financiare ndërkombëtare, nëpërmjet nënshkrimit të titullit të parë financiar MREL me investitorë profesionistë të tregut financiar, si BERZH dhe Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar.

Marrëveshja për këtë titull financiar të emtuar për herë të parë në Ballkanin Perëndimor dhe të nënshkruar plotësisht nga investitorë të tregut financiar ndërkombëtar, është ende aktive në formën e një huaje afatmesme, duke reflektuar besimin në sektorin bankar shqiptar. Ky instrument vijon të plotësojë të gjitha kriteret rregullatore për përmbushjen e kërkesës për MREL.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, ka pasur interes të lartë të investitorëve institucionalë ndërkombëtarë ndaj financimeve në sektorin bankar vendas. Kështu, në fund të vitit 2025, sektori bankar zgjeroi financimin me investitorë të huaj, duke realizuar një tjetër marrëveshje financimi, në trajtën e një instrumenti huaje. Kjo marrëveshje u nënshkrua me Black Sea Trade and Development Bank për qëllime përdorimi si instrument i detyrimeve të pranuar në formën e detyrimeve të pagarantuara (MREL). Ky instrument është njohur si "detyrim i pranuar" nga Banka e Shqipërisë si Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, pasi plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në rregulloren



78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar".

Gjatë periudhës, sektori bankar ka arritur edhe një marrëveshje tjetër financimi, duke siguruar një hua afatgjatë nga një prej grupeve bankare evropiane, instrument ky që gjithashtu plotëson të gjitha kriteret për t'u klasifikuar si "detyrim i pranuar".

Zhvillimet e mësipërme reflektojnë besimin në sektorin bankar shqiptar dhe përafrimin e kuadrit rregullator evropian nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, këto investime nxisin interesin e investitorëve në financimin e titujve të emetuar nga bankat, në kuadër të përmbushjes së kërkesave për MREL.




III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL

Sektori bankar është bërë më aktiv në financimin e kërkesave rregullatore përmes emetimit në tregun e kapitalit në vend. Titujt financiarë të emetuar pas vitit 2021 kanë shërbyer për të plotësuar njëkohësisht kërkesën për kapital rregullator dhe kërkesën MREL, ndërsa emetimet e kryera deri në vitin 2021 kanë shërbyer për plotësimin e kërkesës për kapital rregullator.

Gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2025, duke përfshirë emetimet në të gjitha monedhat, sektori bankar ka emetuar, në formën e obligacioneve me ofertë private, një shumë prej 7.1 miliardë lekësh, ndërkohë që vlera e emetimeve ka qenë rreth 12.5 miliardë lekë për të gjithë vitin, kundrejt 9.2 miliardë lekëve të një viti më parë. Emetimi për vitin 2025 përfshin borxh të varur në vlerën 5 miliardë lekë dhe borxh të pagarrantuar në vlerën 7.5 miliardë lekë. Pjesa e emetimeve të kryera nga bankat MREL zë 90.2% të totalit të emetimeve të bankave të sistemit. Titujt financiarë të borxhit të varur janë detyrime të nënrenditura, të cilat emetohen kryesisht për qëllime të kapitalit rregullator e njëkohësisht shërbejnë edhe për qëllime të financimit të MREL. Titujt financiarë të borxhit të pagarrantuar janë detyrime senior të njohura si "detyrime të pranuar", të cilat sipas hierarkisë së kreditorëve në rast likuidimi të detyruar, në zbatim të ligjit nr. 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, renditen përpara titujve të kapitalit rregullator dhe shërbejnë për qëllime të financimit të MREL.

Grafik 9. Emetimet e letrave me vlerë sipas monedhave, 2015 – 2025




Burimi: AMF, përpunime të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket monedhës së emetimit të këtyre instrumenteve, për këtë periudhë, emetimi në monedhën vendase shënon 6.87 miliardë lekë, emetimi në Euro shënon rreth 5.4 miliardë lekë dhe në monedhën Dollar amerikan shënon rreth 216 milionë lekë.



Grafik 10. Emetimet e letrave me vlerë sipas grupit të bankave, T4 2021 – 2025




Burimi: AMF, përpunime të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Për bankat MREL, në fund të vitit 2025, emetimet në monedhën vendase shënojnë afërsisht 59% të emetimeve totale, kundrejt 41% të tyre në monedhën Euro dhe Dollar amerikan, ndërkohë që për sektorin bankar ky raport qëndron në 55% në monedhë vendase dhe 45% në Euro dhe Dollar amerikan. Për këtë periudhë, obligacionet e pagarantuara përbëjnë rreth 66% të emetimeve të reja për bankat MREL, ndërsa borxhi i varur rreth 34% të tyre. Për gjithë sektorin bankar, ky raport shënon vlerat respektive 60% dhe 40%.

Për vitin 2025, emetimet në monedhë të huaj në formën e "detyrime të nënrenditura" ose ndryshe borxhit të varur zënë rreth 24.7% të stokut total të emetimeve të bankave MREL, kundrejt obligacioneve të pagarantuara në monedhë të huaj që zënë rreth 16% të totalit të emetimeve të bankave MREL. Në këto emetime, individët vijojnë të mbajnë një peshë të rëndësishme krahasuar me personat juridikë, (99.6%) të titujve të emetuar të letrave me vlerë.





Emetimet sipas monedhave kanë pasur zhvillime dinamike ndër vite. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, emetimet e borxhit të pagarrantuar në Lek kanë zënë peshën kryesore të totalit të emetimeve me 90% të tyre, në ndryshim nga gjashtëmujori i dytë i vitit, ku emetimet në Lek dhe Euro shënuan përkatësisht 41% dhe 59% të totalit të emetimit. Për gjithë vitin 2025, emetimet në Lek të detyrimeve të pranura në tregun e kapitalit kanë zënë rreth 76% të emetimeve, duke ndërruar prirjen e viteve të mëparshme për emetimet në monedhë të huaj, ku në vitin 2024, emetimet e borxhit të pagarrantuar në monedhë të huaj përbënin rreth 69% të totalit, dhe në vitin 2023, emetimet e borxhit të pagarrantuar u realizuan vetëm në monedhë të huaj.


Për bankat MREL, kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur këto emetime mbetet i kënaqshëm, në nivelin 77% të nënshkrimit të emetimeve të miratuara. Interesi në treg ka qenë më i lartë për nënshkrimin e emetimeve në Lek dhe Euro dhe më pak në Dollar amerikan.

Emetimet e titujve të borxhit të pagarrantuar për qëllime të MREL kanë reflektuar afate maturimi prej 3, 4 dhe 5 vitesh. Ndërkohë, instrumentet e borxhit të varur ruajnë afate maturimi 7-vjeçare, pa reflektuar ndryshime përgjatë viteve.

Në lidhje me koston e financimit në tregun e kapitalit, norma vjetore e ponderuar e interesit për sektorin bankar ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar qëndrueshmërinë e normave të interesit në tregun financiar, si dhe vlerësimin për primin e rrezikut të këtyre instrumenteve. Ndryshim ka pësuar norma mesatare e interesit për monedhën Dollar amerikan, duke reflektuar një rritje në 5%, nga 3.5% që ishte në fund të vitit 2024.





Grafik 12. Norma e ponderuar e interesit për emetimet sipas monedhave, T4 2015 – 2025



Kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur emetimet për gjashtëmuajorin e dytë 2025 paraqitet i kënaqshëm. Gjatë vitit 2025, investitorët kanë blerë rreth 73% të vlerës totale të titujve të miratuar për emetim në treg, duke shënuar një rritje të lehtë kundrejt vlerës 70% në vitin 2024. Në terma mesatarë, gjatë periudhës 2014-2025, ky tregues është luhatur në vlerat 63% - 100%. Gjatë vitit 2025, portofoli në Lek është blerë nga investitorët në një masë më të lartë, përkatësisht prej 76% të vlerës së miratuar, kundrejt portofolit në Euro, i cili është blerë në masën 68%.

Grafik 13. Raporti i vlerës së nënshkruar të emetimeve sipas monedhave, 2015 – 2025



IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR

Ndikimi i përmbushjes së kërkesës për MREL në përfitueshmërinë e sektorit bankar dhe koston përkatëse të financimit është i dyanshëm. Ky ndikim përfshin: (i) efektin që vjen nga emetimi i titujve të rinj financiarë për të përmbushur nivelin përfundimtar të MREL; dhe (ii) efektin që vjen nga kostoja e shërbimit të borxhit, për titujt ekzistues në bilancin e sektorit bankar, të cilët janë të pranuar për MREL.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2025, ecuria e normave të interesit është reflektuar në rezultatin neto nga interesi për sektorin bankar. Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm ekonomikë kanë ndikuar të ardhurat neto nga interesi për të gjithë sektorin dhe aftësinë e tij për të përballuar koston shtesë të financimit të kërkesave rregullatore.


Sidoqoftë, kostoja e financimit të stokut të letrave me vlerë në bilancin e sektorit bankar vijon të mbetet e kufizuar, në kushtet e treguesve të qëndrueshëm të përfitueshmërisë. Ndërkohë, simulimet mbi ndikimin që mund të ketë emetimi në vijimësi i titujve të rinj financiarë për përmbushjen e nivelit përfundimtar të MREL, tregojnë ndjeshmëri ndaj luhatjeve në normat e interesit për banka të veçanta.

ZHVILLIMET NË PËRFITUESHMËRI

Ecuria e faktorëve të përgjithshëm të ekonomisë së brendshme dhe asaj të jashtme është reflektuar në përfitueshmërinë e sektorit bankar. Konkretisht, në fund të gjashtëmujorit të dytë 2025, rezultati neto nga interesi pësoi një rritje vjetore prej 1.5%, duke shënuar një nivel prej 72.6 miliardë lekësh. Ky rezultat është ndikuar kryesisht nga bankat e tjera, ndërkohë që bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL kanë shënuar një rënie të rezultatit neto nga interesi. Për gjashtëmujorin e dytë 2025, rezultati neto nga interesi për bankat MREL arriti një nivel prej rreth 52.3 miliardë lekësh, duke kontribuar në rreth 71.9% të totalit të sektorit. Në krahasim me fundin e vitit të mëparshëm, ky kontribut ka shënuar një rënie prej 2.1 pikë përqindje.




Grafik 14. Rezultati neto nga interesi për sektorin dhe bankat MREL



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, treguesi i marzhit neto të interesit, i llogaritur si raporti i të ardhurave neto nga interesi ndaj aktiveve mesatare që sjellin të ardhura, vijon të reflektojë një ecuri pozitive. Gjithsesi, në muajin dhjetor 2025, ky tregues kishte një nivel prej rreth 3.9%, me një prirje rënëse në krahasim me fundin e vitit 2024. Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL vijojnë të ruajnë në përgjithësi një nivel pak më të ulët të rezultatit neto nga interesi në krahasim me bankat e tjera të sektorit, duke reflektuar strukturën e tyre të financimit. Për periudhën, marzhi neto nga interesi ka pësuar rënie si për bankat MREL, për të cilat ky tregues shënon 3.8%, ashtu edhe për bankat e tjera, të cilat paraqesin një marzh më të lartë në një nivel prej 4.2%, pra mbi normën e totalit të sektorit bankar.

Grafik 15. Marzhi neto nga interesi, sipas grupit të bankave




Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.



ZHVILLIMET NË KOSTON E FINANCIMIT

Në terma absolutë, ecuria e normave të interesit ndikon drejtpërdrejt në koston e financimit të MREL përmes emetimeve të titujve financiarë. Fokusi i kësaj analize janë bankat, të cilat kanë emetuar tituj borxhi. Ato kryejnë emetime të tilla për qëllime të përmbushjes së kërkesave për kapital rregullator ose të kërkesave për detyrime të pranuar (në rastin e bankave që u nënshtrohen kërkesave për MREL).

Shpenzimet e interesit për klientët vijojnë të përbëjnë peshën kryesore të shpenzimeve të sektorit bankar. Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2025, pesha e shpenzimeve të interesit paguar klientëve qëndron në nivelin e 22.7% të rezultatit neto nga interesi. Këto shpenzime kanë treguar një prirje rritëse në krahasim me fundin e vitit 2024, por kanë rënë lehtësisht krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2025, duke shënuar përkatësisht 20.5% dhe 23% të rezultatit neto në nivel sektori në këto periudha.



Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit të paguar për borxhin e varur dhe letrat e tjera me vlerë zënë një peshë më të ulët prej rreth 3.3% të rezultatit neto nga interesi. Pesha e shpenzimeve për borxhin e varur zë 1.9% të rezultatit neto nga interesi në nivel sektori. Këto shpenzime kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me fundin e vitit 2024 dhe me gjashtëmujorin e parë 2025.


Ndërkohë, në vijim të emetimeve në tregun financiar të instrumenteve të detyrimeve të pranuar emetuar për qëllime të përmbushjes së kërkesës për MREL, shpenzimet për interesa për letrat me vlerë përbëjnë rreth 1.4% të rezultatit neto të gjashtëmujorit të dytë 2025. Ndikuar nga kushtet e tregut financiar dhe cikli i emetimeve, këto shpenzime kanë shënuar një rritje të lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e parë 2025, periudhë në të cilën qëndronin



në nivelin e 1.1% të rezultatit neto në nivel sektori, por gjithsesi mbeten poshtë nivelit prej 1.5%, në të cilin paraqiteshin në fundin e vitit 2024.

Sipas grupit të bankave, treguesit për koston e financimit reflektojnë strategjinë e financimit të aktivitetit dhe modelin e biznesit për secilën bankë. Më konkretisht, në dhjetor 2025, për grupin e bankave që i nënshtrohen kërkesave për MREL, shpenzimet e interesit paguar klientëve zënë një peshë më të ulët në krahasim me nivelin e sektorit, përkatësisht në nivelin e 19.6% të rezultatit neto nga interesi. Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit për letrat me vlerë zënë 1.5% të rezultatit neto nga interesi, ndërsa ato për borxhin e varur zënë rreth 2% të tij. Edhe grupi i bankave të tjera paraqet, gjithashtu, shpenzime për interesa të borxhit të varur, por e përdor atë për qëllime të përmbushjes së kërkesave për kapital rregullator. Në krahasim me bankat MREL, ky grup bankash shënon një peshë më të lartë të shpenzimeve të interesit të paguar për klientët (30.6%), por disi më të ulët për borxhin e varur (1.7%) dhe për letrat me vlerë (1.1%).

Grafik 17. Peshë e shpenzimeve të interesit për letra me vlerë dhe borxh të varur ndaj rezultatit neto nga interesi




Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.

Duke marrë në konsideratë stokun ekzistues të borxhit të varur të mbajtur nga sektori bankar, raporti midis shpenzimeve të interesit dhe stokut të borxhit të varur shënoi një nivel prej 4.8% në fund të gjashtëmuorit të dytë 2025. Për grupin e bankave MREL, kjo peshë qëndron në nivelin e 5% për periudhën e analizuar, krahas nivelit prej 4.1% për bankat e tjera. Raporti më i lartë i koston së financimit të stokut ekzistues të borxhit të varur për bankat MREL në krahasim me bankat e tjera, reflekton stokun më të lartë të borxhit që mbajnë këto banka në bilanc, por edhe aktivitetin më të lartë e më të hershëm të emetimit të titujve të borxhit, tashmë të akumuluar në bilancet e tyre. Gjithsesi, kostoja e stokut ekzistues të borxhit të varur është përthithur dhe reflektuar në llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të bankave, pa ndikuar në mënyrë materiale në rezultatin neto financiar të tyre.



Në tërësi, në vijim të analizave të paraqitura në këtë seksion, vlerësohet se ndikimi ende i kufizuar i përmbushjes së kërkesave rregulatore për MREL në bilancin e sektorit bankar është zbutur nga disa faktorë. Së pari, nivelet e kënaqshme të kapitalizimit të këtij grupi bankash ndër vite kanë lehtësuar procesin e përmbushjes së niveleve të ndërmjetme të MREL përmes kapitalit rezervë të lirë në bilanc. Në mënyrë specifike, njëra prej bankave që i nënshtrohen kërkesës për MREL, vijon të përmbushë plotësisht nivelin përfundimtar të MREL nëpërmjet instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë, duke lehtësuar presionin e emetimeve shtesë në tregun vendas. Së dyti, tregu i kapitalit në Shqipëri ka shfaqur aftësi të mira për të përthithur nevojat e bankave për financim, pa kosto shtesë për bankat që i nënshtrohen kërkesave për MREL. Së treti, sektori bankar ka filluar diversifikimin e strategjisë së financimit të kërkesës MREL, duke rritur financimin përmes burimeve në tregun ndërkombëtar. Në tërësi, ruajtja e besimit të tregut në sektorin bankar është reflektuar në ruajtjen e kostove të financimit të titujve të borxhit, në nivele të përballueshme dhe të qëndrueshme për përfitueshmërinë e sektorit. Bankat e mëdha që u nënshtrohen kërkesave për MREL, vijojnë të reflektojnë një peshë më të ulët të shpenzimeve për interesa ndaj rezultatit neto, veçanërisht për depozitat e klientëve. Së fundi, prania e filialeve të bankave evropiane, të cilat kanë zgjedhur të financojnë MREL përmes institucioneve financiare ndërkombëtare apo institucionit mëmë të grupit bankar, në linjë me strategjinë e ndjekur në bankën mëmë, ka lehtësuar në tërësi kërkesën për financim në tregun vendas, duke zbutur edhe presionet përkatëse në normën e interesit.

Banka e Shqipërisë vijon të monitorojë me kujdes zhvillimet në koston e financimit të kërkesave rregulatore përgjatë periudhës tranzitore deri në fund të vitit 2027, në kushtet e rritjes graduale të objektivit të ndërmjetëm të kërkesës për MREL.



HAPËSIRË INFORMUESE: NDIKIMI I RRIJTJES SË NORMAVE TË INTERESIT NË KOSTON E FINANCIMIT TË MREL


Analiza e mëposhtme synon të masë ndikimin e një rritjeje të mundshme në normat e interesit, gjë që mund të sjellë kosto më të larta për bankat për rifinancimin e stokut të tyre të borxhit. Në mënyrë të veçantë, analiza vlerëson ndjeshmërinë e treguesve të përfitueshmërisë së bankave MREL, në rast se rritja e normës së interesit çon në kosto më të larta rifinancimi, në krahasim me periudhën në të cilën është emetuar fillimisht titulli i borxhit. Bankat që kanë emetuar borxh të varur me maturitet afatmesëm mund të jenë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Për të kryer një vlerësim paraprak mbi ndikimin e ndryshimit të këtyre normave nëpërmjet disa simulimeve hipotetike, është konsideruar që të gjitha bankat janë në përmbushje të plotë të kërkesave për MREL, si për objektivat e ndërmjetëm vjetorë, ashtu edhe për objektivin përfundimtar të vitit 2027. Simulimet mbështeten në supozimin e një bilanci statik deri në vitin 2027. Gjithashtu, simulimet nuk marrin në konsideratë ndryshimet e mundshme në kërkesat rregullative mbikëqyrëse apo makroprudenciale gjatë kësaj periudhe. Së fundi, analiza përjashton bankat që tashmë e plotësojnë nivelin përfundimtar të kërkesës për MREL dhe analizon vetëm ato banka që ende kanë nevojë të emetojnë tituj financiarë për të përmbushur objektivin përfundimtar. Këto banka zënë 49.4% të aktiveve të sektorit bankar.

Ndikimi i përmbushjes së kërkesës MREL në përfitueshmërinë e bankave vlerësohet në dy drejtime. Së pari, vlerësohet kostoja e financimit të stokut aktual të detyrimeve të pranvara dhe së dyti, merren në konsideratë nevojat vjetore shtesë për financimin e MREL deri në arritjen e objektivit përfundimtar në vitin 2027.

Në këto kushte, është ndërtuar skenari bazë, në të cilin supozohet që normat e interesit nuk pësojnë ndryshime përgjatë viteve 2026-2027. Më tej, janë ndërtuar dy skenarë hipotetikë, në të cilët supozohet një rritje e normës së interesit përkatësisht me 1 dhe 2 pikë përqindjeje gjatë kësaj periudhe. Pas vlerësimeve të kryera, rezultatet e kësaj analize paraqiten në mënyrë të përmbledhur në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 18. Ndikimi i ndryshimit të normës së interesit në rezultatin neto nga interesat dhe koston e shërbimit të borxhit për bankat (në terma mesatarë)



Burimi: Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë.



Rezultatet e analizës së përmblodhur në Grafikon 18, tregojnë se kostoja e përmbushjes së MREL paraqitet e përballeshme, duke arritur në 3.2% të të ardhurave neto nga interesi në vitin 2027, për skenarin bazë. Për të gjitha bankat, vlerësohet që kostoja e financimit të detyrimeve ekzistuese të pranuara mund të përthithet plotësisht në rezultatin neto financiar të bankave, pa ndikuar ndjeshëm në përfitueshmërinë e tyre. Gjithsesi, duhet theksuar se analiza nuk merr në konsideratë përforcimin e vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit të bankës përmes certifikimit të fitimit, i cili zbut pjesërisht efektin që vjen nga varësia më e lartë për të financuar MREL përmes emetimit të borxhit të ri.

Në tërësi, vlerësohet se kostoja për shërbimin e borxhit për qëllime të MREL do të vijojë të shënojë rritje për të gjitha bankat, por mbetet e kufizuar në terma relativë të treguesve të përfitueshmërisë. Zhvillimet në sektorin bankar gjatë periudhës, veçanërisht forcimi në vijimësi i pozicionit të kapitalit përmes fitimit që bankat kanë realizuar gjatë vitit të mëparshëm, ul nevojën shtesë për financim të MREL dhe përbën faktorin kryesor zbutës të kostonë së financimit. Në çdo rast, sektori bankar vijon të raportojë vlera të kënaqshme të rezultatit neto nga interesi dhe të treguesve të përfitueshmërisë, edhe në skenarët më të rënduar.

